

Боби Бадаревски

Lars-Erik Caderman (ed.)
**Constructing Europe's Identity:
 The External Dimension,**
 Boulder and London:
 Lynne Rienner Publishers, 2001.

Bobi Badarevski

Lars-Erik Caderman (ed.)
**Constructing Europe's Identity:
 The External Dimension,**
 Boulder and London:
 Lynne Rienner Publishers, 2001.

Книгата *Конструирајќи го европскиот идентитет* од Ларс-Ерик Кадерман се заснова на истоимената интернационална конференција, одржана под водство на авторот. Во време кога Македонија се бори за интеграција во Европската унија, прашањето за европскиот идентитет станува интересно и за пошироката македонска јавност.

Што е или кој е идентитетот на Европската унија? Како да се постигне тој идентитет, имајќи го предвид фактот дека таа претставува конгломерат од држави со различна историја и култура? Што претставуваат границите на Европската унија? Ова се само дел од прашањата што ја контекстуализираат концепцијата на конференцијата, односно на книгата. Како што наведува самиот автор, прашањето за идентитетот на Европската унија последниве дваесетина години сè повеќе станува тема како на политички собири, така и на научни конференции. Притоа, централното прашање коешто се претвора во дилема, но и во проблем, е дали идентитетот на Европската унија истовремено е европскиот идентитет.

Така поставено, прашањето на идентитетот го содржи во себе и прашањето на границите на Европската унија: дали границите, надворешните грани-

Libri Duke konstruktuar identitetin evropian nga Lars-Erik Kaderman-i bazohet në Konferencën me po të njëjtin emër të mbajtur nën udhëheqjen e autorit. Gjatë kohës kur Maqedonia po lufton për integrim në Bashkimin Evropian, çështja e identitetit evropian bëhet interesante edhe për mendimin e publikut më të gjerë maqedonas.

Çfarë është ose cili është identiteti i Bashkimit Evropian? Si të arrihet ai identitet, duke pasur parasysh faktin se ai është një konglomerat shtetesh me histori dhe kultura të ndryshme? Çfarë paraqesin kufijtë e Bashkimit Evropian? Këto janë vetëm një pjesë e çështjeve që e kontekstualizojnë koncepcionin e konferencës, përkatësisht të librit. Siç vë në dukje vetë autori, çështja e identitetit të Bashkimit Evropian njëzet vjetëve të fundit gjithnjë e më shumë bëhej temë si e tubimeve politike, ashtu edhe e konferencave shkencore. Çështje qendrore, me këtë rast, e cila shndërrohet në dilemë, por edhe në problem është se a është identiteti i Bashkimit Evropian njëherësh edhe identitet evropian.

Kështu e shtruar çështja e identitetit e përmban në vete edhe çështjen e kufijve të Bashkimit Evropian: a janë kufijtë, kufijtë e jashtëm të Bashkimit Evropian njëherësh

ци на Европската унија се истовремено граници на Европа како историско-цивилизациона категорија, или европскиот идентитет се однесува само на Европската унија како политичко-економска целина. Идејата е дека теоретизирањето за надворешните граници на „Европа“ на најдиректен начин го поставува прашањето на идентитетот: границите не се само географски туку и политички и економски, и нивната идентификација преку анализа на сегашните политики на Европската унија ќе ни помогне да ги откриеме граничните на тие простори.

Иако книгата е издадена пред Турција да ги започне преговорите за членство во Европската унија, таа ги антиципираше прашањата за надворешните граници на „Европа“ како христијански клуб, откривајќи ни дека станувањето дел од Европската унија не претставува само исполнување на низата политички, економски и социјални услови. Приемот на Турција, како доминантно исламска земја, значи дека не е едноставно да се откријат есенцијалните столбови на европскиот идентитет.

Зборникот исто така не впушта во послободни теориски разгледувања кога станува збор за некои новосоздадени категории, како што е категоријата Западен Балкан, кои ниту политички ниту историски не постоеле како такви. Поентата што ја нудат текстовите е дека Европската унија преку своите политики инсистира на развивање на демократските процеси и почитување на човековите права во земјите од своето опкружување, како вредности на кои се темелат европските институции. Сепак, „Европа“ дозволи прашањето за кандидатскиот статус на Македонија да стане предмет на пресметки помеѓу Ширак и Блер околу буџетот на Европската унија за 2006. Прашањето за идентитетот е сепак посериозна тема.

edhe kufij të Evropës si kategori historike-civilizuese ose identiteti evropian ka të bëjë vetëm me Bashkimin Evropian si tërësi politike-ekonomike. Ideja është se teorizimi i kufijve të jashtëm të “Evropës” në mënyrë më të drejtpërdrejtë e shtron edhe çështjen e identitetit: kufijtë nuk janë vetëm gjeografikë, por edhe politikë dhe ekonomikë dhe identifikimi i tyre përmes analizës së politikave të tashme të Bashkimit Evropian do të na ndihmojë t’i zbulojmë “gurët” e kufirit të këtyre hapësirave.

Edhe pse libri është botuar para se t’i fillojë negociatat Turqia për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ajo i anticiponte çështjet për kufijtë e jashtëm të “Evropës” si klub i krishterë, duke zbuluar të bërit pjesë e Bashkimit Evropian nuk paraqet vetëm plotësimin e një varg kushtesh politike, ekonomike e sociale. Pranimi i Turqisë si vend dominant islamik do të thotë se nuk është e thjeshtë të zbulohen shtyllat thelbësore të identitetit evropian.

Përmbledhja po ashtu na fut në shqyrtime më të lira kur bëhet fjalë për disa teori të krijuara së fundi, siç është kategoria Ballkani perëndimor, të cilat as politikisht e as historikisht nuk kanë ekzistuar si të tilla. Poenta të cilën e ofrojnë tekstet është se Bashkimi Evropian përmes politikave të veta insiston që të zhvillohen proceset demokratike dhe respektimi i të drejtave të njeriut në vendet e rrethimit të vet, si vlera në të cilat bazohen institucionet evropiane. Megjithatë, “Evropa” lejoi që çështja e statusit të kandidatit të Maqedonisë të bëhet lëndë e pastrimit të hesapeve midis Shirak-ut dhe Bler-it rreth buxhetit të Bashkimit Evropian për vitin 2006. Çështja e identitetit, megjithatë, është një temë më serioze.

Përkthim: Lindita Ahmeti